

MALI I ZI
KOMUNA E GUCISË
Sekretariati për administratë të
përgjithshme dhe veprimtari
shoqërore
Numër: 02 – 4432
Guci, 02.10.2024



Adresa: Carsijska nr.28
84326 Guci, Mali i Zi

Tel/fax: +382 51 250 157

E-mail: opstauprava@opstinagusinje.me

Web portal: www.opstinagusinje.me

Bazuar në nenin 71 pika 8 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 002/18, 034/19 dhe 038/20), nenin 9 paragrafi 1 pika 7 të Vendimit për organizimin dhe mënyrën e funksionimit të pushtetit lokal të Komunës së Gucisë ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale", nr. 042/20) dhe Vendimit për bursimin e studentëve të Komunës së Gucisë ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale", nr. 004/18 dhe 003/20), Sekretariati për Administratë të përgjithshme dhe veprimtari Shoqërore i Komunës së Gucisë, shpallë:

KONKURS

për ndarjen e bursave studentore për vitin akademik 2024/25

Të drejtën për bursë mund ta ushtrojnë studentët e rregullt të studimeve themelore të aplikuara dhe studimeve themelore akademike, të cilët:

- kanë shtetësi malazeze,
- kanë vendbanim në Komunën e Gucisë,
- sipas planprogramit të institucionit të arsimit të lartë ku studiojnë, kanë të kaluar vitin paraprak të studimit me notën mesatare mbi 8.50 dhe të paktën 90% të kredive ECTS,
- janë regjistruar për herë të parë në semestrin e vitit akademik,
- nuk kanë përsëritur asnjë vit gjatë studimeve të tyre,
- nuk janë të punësuar,
- nuk janë më të vjetër se 25 vjeç.

Të drejtë për të fituar bursën kanë nxënësit bartës të diplomës "Pishtari A" ("Luča") për vitin e parë të studimeve në rast se menjëher pas përfundimit të shkollës së mesme i regjistrojnë studimet, me kushtin:

- Të jenë shtetas të Malit të Zi ose të kenë statusin e të huajit me qëndrim të përhershëm në Mal të Zi
- Të kenë vendbanimin në komunën e Gucisë
- Për herë të parë të kenë regjistruar semestrin e vitit akademik

Për shkak të mungesës së kadrove deficitar, jepet **bursë e posaçme** për studimet në **Mjekësi, Arkitekturë, Ndërtimtari dhe Bujqësi.**

Të drejtën për bursë të **posaçme** mund ta ushtrojnë studentët që plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara në Vendimin për bursa studentore në Komunën e Gucisë dhe të cilët, sipas planprogramit mësimorë të institucionit të arsimit të lartë ku studiojnë, kanë dhënë provimet nga viti i kaluar i studimit me notë mesatare mbi 7.50 dhe të paktën 90% të kredive ECTS.

Të drejtë për bursë të **posaçme** kanë edhe nxënësit të cilët janë bartës të diplomës "Pishtari" ("Luča"), për viti e I të studimeve, nëse mënjherë pas përfundimit të shkollës së mesme janë regjistruar në studimet nga fusha e kuadrove deficitare.

Përfituesit e bursës së **posaçme** janë të detyruar që pas përfundimit të studimeve punët dhe detyrat ti kryejn në territorin e Komunës, sipas sistemit një vit i marrjes së bursës - një vit pune në territorin e Komunës së Gucisë.

Kandidati që konkuron për bursë përveç fletë-aplikimit duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

- formulari për aplikim për bursë (gjindet në web faqen e komunës së Gucisë)
- vërtetim të vendbanimit,
- vërtetim për regjistrimin e vitit të studimit,
- vërtetim për provimet e dhëna të vitit të kaluar,
- vërtetim të shumës së kredive ECTS të fituara,
- vërtetim të notës mesatare të arritur,
- fotokopje të faqes së parë të indeksit me të dhënat themelore.
- dëshmi (deklaratë) që nuk është i punësuar dhe
- xhirollogarinë e hapur në bankë në emrin e studentit/es.

Të drejtë për bursë kanë edhe nxënësit të cilët janë bartës të diplomës "Pishtari" ("Luča"), për viti e I të studimeve, nëse mënjherë pas përfundimit të shkollës së mesme janë regjistruar në studime, për konkurs paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- formulari për aplikim për bursë (gjindet në web faqen e komunës së Gucisë)
- vërtetim të vendbanimit,
- vërtetim për regjistrimin e semestrit në vitin studimorë 2024/2025,
- diploma "Pishtari" ("Luča"), (studenti/ja e vitit të parë),
- xhirollogarinë e hapur në bankë në emrin e studentit/es,
- fotokopje të faqes së parë të indeksit me të dhënat themelore.
- dëshmi (deklaratë) që nuk është i punësuar.

Të drejtë bursimi do të kenë **6 (gjashtë)** studentët e renditur më mirë (studentët me notën mesatare më të mirë nga vitii i kaluar).

Konkursi është i hapur 30 ditë nga data e publikimit në web faqen e Komunës së Gucisë <https://www.opstinagusinje.me>, pra duke përfunduar më **02.11.2024**.

Formularin për aplikim për ushtrimin e të drejtës për bursim, të interesuarit mund ta marrin në byronë e Komunës, i cili është i publikuar edhe në web-faqen e internetit të Komunës së Gucisë.

SHËNIM: Aplikimet e pakompletuara dhe të arritura pas afatit dhe në të cilat nota mesatare e vitit të kaluar nuk është e definuar qartë, nuk do të merren parasysh!

Aplikacionin me biografinë dhe dokumentacionin e kompletuar - të gjitha dëshmitë mbi plotësimin e kushteve të veçanta dhe të përgjithshme dorëzohen në zarf të mbyllur në byronë e Komunës së Gucisë - ndërtesa e Komunës me shënimin: "**Aplikim në konkursin për ndarjen e bursave studentore për vitin akademik 2024/25**".



UD SEKRETARJA

Alina Sehovic

Alina Sehovic